

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren Hakile Ilazi, si dhe procesmbajtësen Miranda Krasniqi Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.A., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.2466/11 te datës 22.05.2012, në praninë e prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të pandehurit M.A., pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt.26.01.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.A., nga fshati, Komuna Ferizaj, data e lindjes....., në të njëjtin vend, nga i ati A., e ëma Xh. e vajzërisë G., i pamartuar , ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

me dt. 04.08.2013 rreth orës 18:50, në pyllin publik, në menaxhimin e Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillimin Rural-zyra në Ferizaj , në Rajonin Ekonomiko Pyjor, Nerodime-Jezerc, në vendin e quajtur ‘Ngastra 36’ , me qëllim të vjedhjes ka prerë 2 copë trungje të ahut të njomë, me diametër 65-70 cm, të gjatë 26m, dhe me vëllim prej 9.32 metra kub, e në vlerë prej 1258.20 € dhe i ka transportuar me traktor,

-me këtë ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 3,6, 11,15,36,39, dhe 73 të KPK-së si dhe nenin 365 dhe 359 të KPRK –së të pandehurin e :

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë me 250€ /dyqind e pesëdhjete euro/ dënimin e shqiptuar do ta paguajë në afat prej 30 ditësh, nga dita plotfuqishmërisë aktgjykimit .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të kërkesës pasuror- juridike Drejtoria për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj, të i'a kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 1258.20/njëmijë e dyqind e pesëdhjete e tetë euro e njëzet cent / €.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 € në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën Ferizaj PP.nr.2466/11 të datës 22.05.2012 ka ngarkuar të pandehurin M.A., për veprën penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.01.2017, në të cilën prokurori i shtetit Sebahate Sinani, mbeti në tersi pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri M.A. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, për të cilën e ngarkon aktakuza, në të gjitha pikat e saj dhe shton se është penduar thellë

për këtë veprë penale dhe premtion se nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme, është hera e parë që bie ndesh me ligjin.

Gjyqtarja konstaton se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par.1 të KPPK-së nga se:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë,
- pranimi i fajit bëhet vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materiale e prezantuar nga prokurori i shtetit si dhe në provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, procesverbali nga vlerësimi dhe llogaritja e dëmit të pyllit nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj me nr.PP.nr.909/11 i dt.30.11.2011

-aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse e akuzuara ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli nga neni 285 par.2 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i gjendjes së varfër ekonomike, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin fillestar, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarës dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 458,459 dhe 460 të KPPK-së, obligohet i akuzuari që në emër të kërkesës pasuror- juridike Drejtoria për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj, të i'a kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 1258.20/njëmijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë euro e njëzet cent / €.

Konformë nen. 450 par.2 pika 6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 (njëzet e pesë) euro, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë .

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM,
P.nr.276/13 e dt.26.01.2017

Procesmbajtësja

Miranda Krasniqi Jashari

Gjyqtarja individuale,

Hakile ILAZI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit Kosovë, përmes kësaj Gjykate.